



## **VENDIM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT**

**Data e miratimit: 19 tetor 2016**

**Numri i lëndës: 2014-32**

**L.O.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 19 nëntor 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Kryesuesja e Panelit, znj. Magda Mierzewska, ka marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj lënde përmes komunikimit elektronik në përputhje me nenin 13(3) të rregullores së punës së Panelit.

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PËRBËRJA E PANELIT**

1. Pas dorëheqjes së znj. Katja Dominik nga Paneli, znj. Elka Ermenkova, anëtare zëvendësuese e Panelit e ka zëvendësuar atë në pajtim me rregullën 11(2) dhe 14(2) të rregullores së punës së Panelit.

### **II. VENDIMI I PANELIT I DATËS 11 NËNTOR 2015**

2. Me 11 nëntor 2015, Paneli ka marrë vendimin rreth ankesës së paraqitur nga L.O. kundër EULEX-it dhe ka bërë një sërë rekomandimesh për shefin e

Misionit (ShM) në përputhje me rregullën 34 të rregullores së punës. Në vendim thuhet si në vijim:

“Paneli, njëzëri

SHPALL ANKESAT LIDHUR ME NENET 2 DHE 3 (PJESËT PROCEDURALE) DHE NENET 8 DHE 13 TË KONVENTËS TË PRANUESHME,

GJEN NJË SHKELJE TË KËTYRE TË DREJTAVE, dhe

DEKLARON se në bazë të gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe ligjit, Paneli gjen të përshtatshme që të bëjë rekomandime për ShM-në, dhe

#### REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME KORRIGJUESE

- a. ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses që i atribuohen veprimeve [dhe/ose mosveprimet] të EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv;
- b. ShM-ja duhet t'i udhëzoj të gjitha organet e Misionit, të cilët janë në kontakt me viktimat e supozuara të shkeljes së të drejtave (ose të afërmeve të tyre) që të sigurojnë se në të gjitha komunikimet me ta të komunikojnë me masën e nevojshme të shpejtësisë, zellit dhe kujdesit të domosdoshëm për ta ditur vuajtjen emocionale të bashkëbiseduesit të tyre. Nëse është e nevojshme, ShM-ja duhet të konsideroj miratimin e udhëzimeve me duke përcaktuar me më shumë hollësi se çfarë mund të nënkupton në rrethana konkrete ky udhëzim i përgjithshëm.
- c. ShM-ja duhet të siguroj që të gjitha organet hetuese në kuadër të Misionit (të TFHS dhe prokurorëve të EULEX-it) kanë në dispozicion burimet e nevojshme dhe mbështetje për të përmbushur misionin e tyre në mënyrë efektive dhe në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të të gjithë të përfshirëve aty. Për këtë qëllim dhe nëse konsiderohet e nevojshme ShM-ja duhet të kërkoj burime shtesë për këto organe në mënyrë që ata të mund të kryejnë funksionet e tyre shpejtë, me kujdes dhe në mënyrë efektive në të gjitha rastet.
- d. ShM-ja duhet të kërkoj që të qartësohet marrëdhënia midis Misionit dhe TFHS-së me qëllim që të sigurohet mbrojtja efektive

e të drejtave dhe të garantohet se secili organ që është në krye të çështjes ofron informacionin e duhur dhe të mjaftueshëm për ankuesit. Nëse është e nevojshme, duhet të kërkohet autorizimi nga BE-ja për të bërë publike bazën ligjore që rregullon punën e TFHS-së. Kjo gjithashtu në masë të madhe do të kontribuoj në sjelljen e transparencës dhe llogaridhënies më të madhe për këtë mekanizëm.

- e. ShM-ja duhet t'ia bëjë të ditur TFHS-në dhe shteteve që mbështesin aktivitetet e tij rëndësinë që rastet e tilla duhet të hetohen në mënyrë të plotë dhe efektive dhe se kudo që të dyshuarit të identifikohen, të sillen para drejtësisë menjëherë dhe në mënyrë të drejtë.
- f. ShM-ja duhet t'ia bëjë të ditur zyrtarët kompetentë të TFHS-së rëndësinë dhe nevojën për të informuar viktimat rreth aspekteve të përgjithshme të hetimit të tyre në mënyrë që t'i njoftojnë ata rreth përpjekjeve dhe angazhimit të tyre për të arritur drejtësinë për ta.

- 3. Vendimi i tanishëm përbën vazhdim të vendimit të datës 11 nëntor 2015 të Panelit dhe të rekomandimeve të bëra në të.
- 4. Kompetencat dhe autoriteti i Panelit për të përcjellë vendimet dhe rekomandimet e tij janë saktësuar në rregullën 45 e tutje të rregullores së punës së Panelit (për shembull shih vendimet mbi zbatimin e rekomandimeve *Desanka nad Goran Stanisic kundër EULEX-it*, 2012-22, 29 shkurt 2016 § 3; *X dhe 115 ankues të tjerë kundër EULEX-it*, 2011-20, 11 nëntor 2015, § 3).

## **II. INFORMACIONI I MARRË NGA SHEFI I MISIONIT TË EULEX-IT LIDHUR ME ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT**

- 5. Me 9 shkurt 2016, Shefi i Misionit ka pranuar marrjen e vendimit dhe rekomandimeve të Panelit.
- 6. Me 15 prill 2016, Paneli i ka dërguar një letër shefit të Misionit, në të cilën vuri në dukje se nuk i kishte marrë komentet e tij lidhur me rekomandimet e tij dhe e ftoj atë që përsëri t'i paraqiste komentet deri me 6 maj 2016.
- 7. Në përgjigje, me letër të datës 29 prill 2016, shefi i Misionit në largim, Gabriele Meucci, si përgjigje ndaj rekomandimeve të Panelit ka deklaruar si në vijim:

“Pasi që rekomandimet e Panelit kanë të bëjnë me masat që janë në dispozicion të CPCC-së [Kapacitete të Administrimit dhe Planifikimit Civil], disa institucioneve të BE-së, si dhe shteteve anëtare, kam informuar CPCC-së dhe shtetet kontribuuese lidhur me vendimin dhe gjetjet e Panelit” përmes komandantit të Operacioneve Civile, dhe në këtë mënyrë e konsideroj që rekomandimi është zbatuar”.

### III. VLERËSIMI NGA PANELI

8. Paneli dëshiron të konstatoj se përkundër asaj çfarë duket se sugjeron deklarata e mësipërme e shefit të Misionit, përgjegjësia për t'i zbatuar rekomandimet e Panelit bie tërësisht dhe ekskluzivisht mbi ShM-në, e jo mbi CPCC-në, e as mbi shtetet anëtare. Në këtë kuptim, përderisa shefi i Misionit mund të vendosë në një rast të veçantë për të kërkuar ndihmën e të tjerëve për të zbatuar rekomandimet e Panelit, në fund të fundit përgjegjësia për zbatimin e tyre mbetet mbi shefin e Misionit.
9. Së dyti, përderisa shefi i Misionit në largim tregon në letrën e tij se ai e ka informuar CPCC-në dhe shtetet kontribuese lidhur me vendimin dhe rekomandimet e Panelit, ai nuk thotë asgjë për përpjekjet e tij, nëse ka pasur ndonjë, për të zbatuar rekomandimet e Panelit. Në veçanti, ShM nuk ka thënë asgjë në lidhje me nevojën që të pranoj shkeljen e të drejtave të ankuesve siç rekomandohet nga Paneli (Rekomandimi (a); shih paragrafin 2 më lartë). Po ashtu ai nuk i ka paraqitur Panelit ndonjë dëshmi të tij që ai ka zbatuar ndonjë prej rekomandimeve të tjera të Panelit (Rekomandimet (b)-(f)). Në këto rrethana, Paneli nuk mund ta konsideroj të përshtatshme përgjigjen e shefit të Misionit.
10. Së fundi dhe në kundërshtim me supozimin e qartë të ShM, përgjegjësia për të vendosur nëse rekomandimet e Panelit janë zbatuar apo jo i takon Panelit. Paneli duhet të theksoj në këtë kontekst se përderisa rekomandimet e tij nuk janë ligjërish të detyrueshme, është thelbësore për kredibilitetin dhe legjitimitetin e EULEX-it, si Mision i sundimit të ligjit, që ai duhet me vendosmëri dhe në mënyrë kredibile të demonstrojë angazhimin e vet në zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut duke siguruar që veprimet e tij janë në çdo kohë në përputhje me këto standarde. Në çdo rast, rekomandimet e Panelit kanë për qëllim që të sigurojnë këtë, në kuadër dhe me kujdesin e duhur ndaj rrethanave të secilit rast veç e veç, në mënyrë që miratimi i këtyre rekomandimeve nga ShM-ja në të gjitha rastet të jep një kontribut pozitiv në mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nga ana e Misionit.
11. Bazuar në konsideratat e mësipërme, Paneli nuk është i bindur që deri më tani ShM ka trajtuar në mënyrë të përshtatshme dhe efektive rekomandimet e Panelit.

#### PRANDAJ PANELI NJËZËRI

*Deklaron se shefi i Misionit nuk i ka zbatuar rekomandimet e Panelit.*

*Fton shefen e re të Misionit që të merr në konsideratë plotësisht secilin dhe të gjitha rekomandimet e Panelit dhe të njoftoj Panelin në përgjigje rreth veprimeve të ndërmarra sa më shpejt që është e mundur.*

*Vendos që ta mbaj rastin.*

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese